



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2196/2 prot.,

Datë 11.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “W.Center” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-73920-06-29-2023, me objekt: “Blerje karbon aktiv per UKT sh.a”, me fond limit 60,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane

Skualifikimin e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues:

Operatori ekonomik “W.Center” SHPK me NIPT K63029402A dhe adresë:, Lagjia 8 Shkurti,Pallati 2 katesh ,Perball "Gjimnazit Perikli Ikonomi", Fier

Autoriteti Kontraktor:

SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik "2 AT" SHPK me NIPT K14019001H dhe adresë: Korçe – Dishnice

Në datën 08.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 2196 prot., e operatorit ekonomik “W.Center” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi

kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-73920-06-29-2023, me objekt: “Blerje karbon aktiv per UKT sh.a”, me fond limit 60,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01.08.2023 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujesjelles Kanalizime Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “W.Center” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar si dhe pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “W.Center” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

2.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “W.CENTER“ sh.p.k me ofertë 51.783.370 (pesedhjetë e nje milion e shtateqind e tetedhjetë e tre mijë e treqind e shtatedhjetë) leke pa tvsh Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 80, neni 92/3 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar neni 82 si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik nga të cilët rezultoi si më poshtë vijon: Se pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 5, si më poshtë vijon: 5 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizën e parametrave të sigurisë sipas (S SH EN 12903: 2009) të analizuar në Institutin e Shëndetit Publik ose laboratorë kombëtarë të akredituar sipas legjislacionit në fuqi ose laborator ndërkombetare të akredituara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike të paraqitur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur fletë analize të lëshuar nga Instituti I Shëndetit Publik dhe Çertifikatë analize të lëshuar nga prodhuesi SICAV, dokument ky në të cilin deklarohet që analizat janë kryer pranë laboratorit të akredituar BIOSAN, por nuk është paraqitur fletë analiza për komponentët e analizuar e lëshuar nga ky laborator. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ju bën me dije se, në fletë analiza e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi nuk janë të analizuar të gjitha komponentët e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Autoriteti Kontraktor ka specifikuar në kriterin e sipërcituar, që fletë analiza duhet të jetë në përputhje me standartin S SH EN 12903:2009, ku duhet të jenë të analizuar të gjithë komponentët e kërkuar, si rrjedhojë u është lënë hapësirë të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që fletë analiza e kërkuar të kryhet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe pjesa e komponentëve që nuk kryhen nga ISHP, të kryhen pranë

laboratorëve kombëtar/ndërkombëtar të akredituar. Operatori ekonomik “W.Center” ka paraqitur vetëm fletë analizën e kryer pranë ISHP, duke mos i plotësuar të gjithë komponentët e kërkuar për tu analizuar, e cila është e paplotë. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, neni 92/3të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 79, neni 80, neni 82 e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik “W. Center” SHPK” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK si më poshtë vijon:

Në lidhje me ofertën e paraqitur nga ana e operatorit “2AT” shpk, ofertë e cila është kualifikuar nga Autoriteti Kontraktor dyshojmë se dokumentacioni i paraqitur në lidhje me fletën e analizës së produktit nga prodhuesi nuk është i saktë dhe se prodhuesi i produktit nuk ka një laborator të akredituar. Në këto kushte kërkojmë nga ana juaj që të rishikoni dokumentacionin e paraqitur nga operatori në fjalë dhe në rast se konstatohen dyshimet tona të skualifikoni ofertën e paraqitur prej tij.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 11.09.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri